



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

28.01.2021

Për : **Operatorin ekonomik KASTRATI sh.p.k**

Adresa: **Lagja 14, Rruga Tirana, Pranë Gjykates së Apelit, Shkozë, Durrës**

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-81303-12-07-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje karburant”**, me fond limit **5.250.000** (pesëmilionë e dyqind e pesëdhjetëmijë) **lekë pa TVSH**, i vënë në dispozicion nga të ardhurat e bashkisë Shijak dhe me kohëzgjatje 12 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës nga ana e palëve.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [**Data 14.12.2020, Numri 119**]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik A&T sh.a, numri i NIPT-it : **L32320008H**

Vlera: Ofertë ekonomike me marzh fitimi **9.91%**.

2. Operatori ekonomik KASTRATI sh.p.k, numri i NIPT-it : **J61813529P**

Vlera: Ofertë ekonomike me marzh fitimi **16.4%**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. A&T sh.a, numri i NIPT-it : **L32320008H**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

b. Eshte kerkuar qe ofertuesi te kete jo me pak se 2 stacione te shitjes se karburantit me pakice ne qarkun e Durrës, te pasqyruara ne ekstraktin tregtar dhe te pajisur me autorizim per tregtim karburanti me pakice te leshuar nga njesia e qeverisjes vendore, nga verifikimi i

kryer ne ekstraktin e regjistrimit tregtar, ju nuk keni asnje stacion te shitjes se karburantit ne qarkun Durres.

Nga verifikimi ne teresi i dokumentave te paraqitura nga ana juaj per permbushjen e kriterit te lartepemendur, ju keni paraqitur dokumentacion (ekstraktin e regjistrimit tregtar) te subjektit Olsi sh.p.k, i cili nuk eshte ofertues ne kete procedure.

Rezulton se A&T sh.a dhe Olsi sh.p.k nuk kane krijuar zyrtarisht bashkimin e operatoreve ekonomik, sipas nenit 74 te RPP-se dhe kriterëve te pergjithshme te kualifikimit, cka nenkupton qe Olsi sh.p.k nuk eshte ofertues ne kete procedure.

Persa me siper dhe referuar ne Rekomandimin 8197 prot date 03.09.2018 te APP-es, Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk duhet te vleresoje dokumentacionin e paraqitur nga subjekte qe nuk jane kandidat ne proceduren e prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **KASTRATI sh.p.k**, me adresë: Lagja 14, Rruga Tirana, Pranë Gjykatës së Apelit, Shkozë, Durrës, se oferta e paraqitur, me marzh fitimi 16.4% , është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Shijak, Lagja Erzen, nr.tel: +3555674834342 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **20.01.2021**.

Ankesa: Jo

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Elton Arbana